



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN

Fakulteti Ekonomik – Economics Faculty

Adresa: Rr. Zija Shemsiu, p.n., 60000 Gjilan,
www.uni-gjilan.net, tel. +383 (0) 28039011

Republika e Kosovës / Public University	
Pranuar nga data	13.10.2022
Aksi i punës	05/1860

RAPORT PLOTËSUES I KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK PËR ANGAZHIM NË SEMESTRIN DIMËROR DHE VEROR - VITI AKADEMIK 2022/23 NË FAKULTETIN EKONOMIK

Duke u bazuar në Vendimin 01/1796, dt.07.10.2022 të Senatit të Universitetit Publik "Kadri Zeka", dhe Rregulloren mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm – me honorar, në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, nr.ref.01/1473, dt.09.07.2021, Komisioni vlerësues në përbërje: Prof.Asoc.Dr. Shefket Jakupi, Prof.Ass.Dr. Nexhat Shkodra dhe Prof.Ass.Dr. Teuta Agaj, ka rishikuar edhe një herë pozitën e 10 në Konkursin me nr. ref. 01/1905, dt.13.09.2021 për angazhim në Fakultetin Ekonomik, viti akademik 2021/22, dhe ka ftuar në intervistë kandidaten Emira Dërmaku.

Intervista është realizuar më 13.10.2022 dhe pas shqyrtimit edhe të dosjes së kandidates, Komisioni ka vendosur si në vijim:

Për pozitën 10 - 10. Një asistent/e - për mbajtjen e ushtrimeve për lëndët në semestrin dimëror: *Marketingu, Kerkimet e marketingut, Menaxhimi i brendit dhe komunikimi, Marketingu ndërkombëtar*; dhe semestrin veror: *Strategjite e marketingut, Menaxhimi i shitjeve, B2B Marketingu* –Komisioni **nuk e propozon kandidaten MSc.Emira Dërmaku** që të zgjidhet për këtë pozitë.

Komisioni mbetet në propozimin paraprak që **PhD.Cand. Asdren Toska, të zgjidhet** për këtë pozitë.

Arsyetim


Deri te ky vendim Komisioni erdhi pas shqyrtimit të dosjes së kandidates Emira Dërmaku dhe realizimit të intervistës, duke mos marrë parasysh faktin se ajo është studente e rregullt në Programin Menaxhment dhe Ndërmarrësi dhe pasi ajo u deklarua para Komisionit se nuk do ta zgjedhë Profilin Menaxhimi i Marketingut dhe Shitjes, në kuadër të të cilit janë lëndët e shpallura për këtë pozitë. Komisioni ka konstatuar kandidatja i plotëson kushtet formalo-juridike sa i përket fushës së studimit dhe notës mesatare por ajo ndodhet në disavantazh të theksuar në raport me kandidatin e propozuar. Ajo nuk ka përvojë në mësimdhënie, nuk ka të regjistruara studimet e doktoratës, nuk ka punime të publikuara shkencore dhe nuk ka pjesëmarrje në konferenca shkencore, përparësi këto që i disponon kandidati i përzgjedhur (shih raportin nr.ref. 05/1527, dt.05.09.2022, pozita 10, i publikuar në web-faqen e UKZ: <https://ëëë.uni-gjilan.net/ep-content/uploads/2022/09/Raporti-i-komisionit-p%C3%ABr-stafin-e-angazhuar-n%C3%ABFakultetin-Ekonomik-n%C3%AB-vitin-akademik-2022-2023.pdf>).

Pala e pakënaqur mund të ankohet pranë Këshillit të Fakultetit Ekonomik, 3 ditë nga dita e publikimit të këtij raporti në web faqen e UKZ-së.


Gjilan, më: 13.10.2022

Anëtarët e Komisionit:

1. Prof.Assoc.Dr. Shelket Jakupi – kryetar



2. Prof.Ass.Dr. Nexhat Shkodra - anëtar



3. Prof.Ass.Dr. Teuta Agaj - anëtar

